



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 69/2021(JR)
Nr. 69/4 Regj.

Tiranë, më 08 05 .2024

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e enjte, më datë **13.06.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit me numër nr. 69/2021 (JR), datë 11.11.2021, që i përket ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit **Kaçe Agolli**, kundër vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.
Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese	Ina Rama
Relatore	Albana Shtylla
Anëtar	Sokol Çomo
Anëtare	Rezarta Schuetz
Anëtare	Mimoza Tasi

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE


INA RAMA
